



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**TIRANË**

Nr. 735 Akti  
Datë 09.09.2019 Regj.

Datë Vendimi 24.09.2019

**V E N D I M**  
**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

**GJYQTARE: Armela HASANTARI**

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Berzana Çobo**, në Tiranë, sot më datë 24.09.2019, pasi mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, kërkesën penale me Nr. 735 Akti, që i përket:

**ANKUES:**

**Agjensia Kolektive e Mbrojtjes së të Drejtave të Autorëve (Albautor)**, me adresë: Blv "Bajram Curri" 114, kati 2, Ap.1, Tiranë, mbrojtur nga Av. Tonin Prendi dhe Av. Erina Leka, anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

**P/INTERESUAR:**

Prokuroria, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori **Ervin Karanxha**.

**OBJEKTI:**

Vënien e sekuestros preventive mbi pasurinë e paluajtshme me nr. 2/213, vol. 47, fq.6, ZK 8270 Tiranë, ambiente në pronësi të Albautor, të cilat në kundërshtim me ligjin janë lejuar për tu shitur në ankand tek palët e treta.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 58 e vijues dhe neni 274 i Kodi i Procedurës Penale.

**Vëren se:**

1. Kërkuesi Agjensia Kolektive e Mbrojtjes së të Drejtave të Autorëve (Albautor) i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën penale me objekt vënien e sekuestros preventive mbi pasurinë e paluajtshme me nr. 2/213, vol. 47, fq.6, ZK 8270 Tiranë, ambiente në pronësi të Albautor, të cilat në kundërshtim me ligjin janë lejuar për tu shitur në ankand tek palët e treta.
2. Kërkuesi e mbështet kërkesën objekt gjykimi në nenet 58 dhe 274/2 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP), si dhe në nenin 36/1 të Kodit Penal.

3. Neni 274 i KPP parashikon se: *“1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.”*

4. Në analizë të kësaj dispozite, kjo Gjykatë vlerëson se, sekuestroja preventive si një nga masat e sigurimit pasuror, në procesin penal, vihet kur ka rrezik që disponimi i sendit në mënyrë të lirë që lidhet me një veprë penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Sekuestroja preventive vendoset domosdoshmërisht me vendim të arsyetuar të gjykatës, bazuar në kërkesën e prokurorit. Gjykata e Lartë, në lidhje me nenin 274 të KPP, shprehet se: *“Në këtë dispozitë lejohet marrja e kësaj mase për shkaqe të ngutshme me kërkesë të prokurorit, i cili duhet të paraqesë dyshime të arsyeshme për implikimin e subjektit në veprimtari të kundraligjshme.”*

5. Në rastin konkret, vendosja e masës së sekuestros preventive kërkohet nga Agjensia Kolektive e Mbrojtjes së të Drejtave të Autorëve (Albautor), e cila rezulton të jetë me cilësinë e viktimës së veprës penale në çështjen penale me nr. 163 Regj.,Them., datë 23.05.2019 regjistrimi.

6. Të drejtat e viktimës së veprës penale parashikohen shprehimisht në nenin 58 të KPP-së sipas të cilit: *“1. Viktima e veprës penale ka të drejtë: a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit; b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale; c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar; ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi; d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor; dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të tjera përpara organit procedues; e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod; ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit; f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen; g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal; 40 gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale; h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore; i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar; j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.”*

7. Sa më sipër Gjykata vlerëson të theksojë se, kërkuesi në rastin konkret nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës me kërkesë për vendosjen e masës së sekuestros preventive. Kjo për arsye se, neni 274 i KPP-së përcakton shprehimisht që kjo masë vendoset nga gjykata, me kërkesën e prokurorit. Pra, prokurori është subjekti i vetëm që ligji i njej të drejtën të bëjë këtë kërkim. Përpos kësaj, vetë neni 58 i KPP-së nuk i garanton viktimitës së veprës penale të drejtën për të kërkuar drejtpërdrejt në gjykatë, kërkesa si kjo objekt gjykimi. Për rrjedhojë, kërkesa penale objekt gjykimi vlerësohet nga Gjykata se është haptazi e pabazuar në ligjin procedural penal.

8. Duke iu referuar sa sipër, Gjykata vlerëson se, kërkesa penale e paraqitur nga kërkuesi Agjencia Kolektive e Mbrojtjes së të Drejtave të Autorëve (Albautor), për vënien e sekuestros preventive mbi pasurinë e paluajtshme me nr. 2/213, vol. 47, fq.6, ZK 8270 Tiranë, duhet të deklarohet e papranueshme për shkak se është bërë nga një subjekt që nuk legjitimohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata bazuar në nenet 58, 274 dhe 453 të K.Pr.Penale,

### **V E N D O S I:**

- Deklarimin e papranueshëm të kërkesës penale me Nr. 735 Regj.Them., datë 09.09.2019, të kërkuesit **Agjencia Kolektive e Mbrojtjes së të Drejtave të Autorëve (Albautor).**
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuesit.
- 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.  
**U shpall në Tiranë, sot më datë 24.09.2019.**

**SEKRETARE**  
**Berzana ÇOBO**

**GJYQTARE**  
**Armela HASANTARI**